

**REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE**



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government**



**Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health**

**Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës**

**Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova**

**RAPORTI I GJENDJES  
PERINATALE NË KOSOVË PËR  
VITIN 2024**

**Departamenti i Mjekësisë Sociale**

**Divizioni për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKShPK**

**Prishtinë, 2025**

**RAPORTI I GJENDJES  
PERINATALE NË KOSOVË PËR  
VITIN 2024**

Departamenti i Mjekësisë Sociale  
Divizioni për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve– IKShPK

Prishtinë, 2025

Botuesi:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Copyright:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Përdorimi i të dhënave lejohet vetëm kur citohet burimi i të dhënave.

**Dokumenti u hartua nga:**

Prof. Dr. Merita Berisha

Dr. Sevdie Spahiu

## Parathënie

Publikimi “Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2024” përfaqëson një përpjekje të vazhdueshme institucionale për të ofruar një pasqyrë sa më gjithëpërfshirëse mbi gjendjen perinatale në vend, bazuar në të dhëna të raportuara nga institucionet shëndetësore publike dhe private, si dhe nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Përkundër përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin e raportimit dhe mbledhjes së të dhënave, mungesat dhe mospërputhjet në të dhënat statistikore mbi lindjet dhe vdekjet vazhdojnë të paraqesin një sfidë të konsiderueshme. Si rrjedhojë, në përgatitjen e këtij raporti janë shfrytëzuar të dhënat e disponueshme nga Departamenti i Statistikave Shëndetësore në kuadër të IKSHPK-së dhe ato të publikuara nga ASK.

Në këtë publikim përfshihen të dhënat mbi definicionet themelore në fushën perinatale, lindjet dhe vdekshmërinë e foshnjave të ndara sipas periudhave të ndryshme të jetës së tyre. Treguesit kryesorë janë paraqitur për periudhën 2000–2024. Lindjet janë të klasifikuara sipas niveleve të kujdesit shëndetësor dhe sektorit të ofrimit të shërbimeve (publik dhe privat), ndërsa të dhënat për të porsalindurit janë ndarë sipas grup-peshës dhe mënyrës së lindjes. Statistikat për foshnjat e vdekura janë analizuar sipas moshës dhe gjinisë së foshnjës, moshës së nënës, statusit martesor dhe nivelit arsimor të saj. Koeficienti i vdekshmërisë infantile është paraqitur sipas komunave, ndërsa koeficienti i vdekshmërisë perinatale – për shkak të kufizimeve në të dhëna – është raportuar vetëm sipas viteve.

Duke pasë parasysh kufizimet në burime relevante të të dhënave rekomandohet që të gjithë përdoruesit e këtij publikimi t’i trajtojnë me kujdes dhe rezervë të dhënat dhe vlerat e indikatorëve të prezantuar, pasi ato mund të mos reflektojnë në mënyrë tërësisht të saktë realitetin e gjendjes perinatale në vend.

Ftojme të gjitha palët e interesuara – institucionet, profesionistët shëndetësorë, studiuesit dhe përdoruesit e tjerë të të dhënave – që të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së raportit përmes komenteve, vërejtjeve dhe rekomandimeve të tyre. Një qasje e tillë bashkëpunuese është thelbësore për zhvillimin e politikave të informuara dhe për forcimin e sistemit shëndetësor në funksion të përmirësimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës në Republikën e Kosovës.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës shpreh mirënjohjen e thellë për të gjitha institucionet shëndetësore të cilat kanë kontribuar në ofrimin dhe raportimin e të dhënave për këtë publikim.

Dr. Ardita Baraku

Drejtor Ekzekutiv i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

## LISTA E PËRMBAJTJES

Prishtinë, 2025 .....	1
Prishtinë, 2025 .....	2
Parathënie .....	5
PËRMBLEDHJE .....	7
DEFINICIONET .....	8
METODOLOGJIA.....	10
TË DHËNAT KRYESORE.....	12
LINDJET .....	14
Trendi i lindjeve .....	18
Trendi i natalitetit.....	19
VDEKSHMËRIA E FOSHNJAVE.....	25
Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil) .....	25
VDEKSHMËRIA FETALE .....	30
VDEKSHMËRIA PERINATALE .....	32
PËRFUNDIMET .....	34
REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË .....	36
BIBLIOGRAFIA .....	38
SHTOJCË.....	39

## PËRMBLEDHJE

Gjendja perinatale përfaqëson një tregues kyç të mirëqenies së popullatës dhe efikasitetit të sistemit shëndetësor të një vendi. Periudha perinatale, që përfshin kohën nga java e 22-të e shtatzënisë deri në ditët e para pas lindjes, është një fazë kritike për mbijetesën dhe zhvillimin e foshnjës. Faktorët biologjikë, social-ekonomikë dhe politik-bërës luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e shëndetit perinatal, duke ndikuar në reduktimin e vdekshmërisë foshnjore dhe komplikimeve obstetrike. Rëndësia e shëndetit perinatal qëndron në reflektimin e gjendjes shëndetësore të vendit dhe cilësinë e sistemit shëndetësor prandaj si i tillë për nga rëndësia është paraparë edhe në objektivin e Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë.

Ky raport synon t'iu ofrojë vendimmarrësve, institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve shëndetësorë të dhëna të përditësuara për të vlerësuar gjendjen aktuale perinatale dhe për planifikimin e ndërhyrjeve të bazuara në evidenca me qëllim të përmirësimit të gjendjes perinatale në Kosovë.

Një element i rëndësishëm i këtij raporti është përqindja e lartë e lindjeve me prerje cezariene në institucionet shëndetësore publike dhe private. Sipas të dhënave të vitit 2024, 46.2% e të gjitha lindjeve në institucionet publike dhe private janë realizuar me prerje cezariene, në institucionet private nga të gjitha lindjet e realizuara, lindje me prerje cezariene ishin 83.0%, përqindje kjo shumë e lartë që tejkalon normat e lejuara.

Prerja cezariene është një ndërhyrje kirurgjikale që mund të shpëtojë jetë në raste të caktuara mjekësore; megjithatë, përdorimi i saj pa indikacione të qarta klinike është i lidhur me një sërë pasojash negative, si për shëndetin e nënës ashtu edhe të foshnjës. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) thekson se normat më të larta se 10–15% të lindjeve me prerje cezariene në një popullatë nuk janë të lidhura me përmirësim të mëtjshëm të mortalitetit perinatal apo maternal. Studimet tregojnë se aplikimi i tepruar i prerjes cezariene mund të rrisë rrezikun e komplikimeve post operatore, infeksioneve dhe problemeve të mëvonshme obstetrike për gratë.

## DEFINICIONET

Indikator Perinatal është indikator kyç dhe sensitiv i gjendjes shëndetësore dhe reflekton kujdesin prenatal, gjatë lindjes dhe kujdesin për të porsalindurit. Po ashtu reflekton si indikator i tërthortë për gjendjen shëndetësore të nënës, organizimin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Definicionet e indikatorëve janë shfrytëzuar nga “Korniza e treguesve të shëndetit të fëmijës dhe nënës” Maj 2018 e cila është produkt i grupit punues në nivel nacional dhe i përkrahur nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit në Republikën e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, IKShPK dhe (United Nations Children`s Fund) Fondi i Kombeve të bashkuara për Fëmijë (UNICEF).

**I lindur** nënkupton shpëputjen e tërësishme të fetusit të vdekur që peshon më shumë se 500 g apo të fetusit të gjallë nga trupi i nënës pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë.

**I lindur gjallë** nënkupton shpëputjen e tërësishme nga trupi i nënës të produktit të konceptcionit, pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë, i cili produkt pas ndarjes, merr frymë apo tregon shenja të jetës si p.sh të rrahurat e zemrës, pulsimit të kordonit të kërthizës apo lëvizje vullnetare të muskujve, pavarësisht nëse kordoni i kërthizës është prerë apo placenta është ngjitur.

**I lindur vdekur** Vdekja para daljes apo nxjerrjes prej nënës së vet e produktit të konceptcionit pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shtatzënësisë; vdekja është përcaktuar sipas faktit se pas ndarjes së tillë fetusit nuk merr frymë apo nuk tregon ndonjë shenjë tjetër jete, siç janë rrahjet e zemrës, pulsimet e kordonit umbilikal apo lëvizjet e përcaktuara të muskujve të vullnetshëm.

Shkalla e të lindurve të vdekur (Vdekshmëria fetale)

**Numri i të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur gjallë** (të lindur gjallë dhe të lindur të vdekur). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes – gjatë shtatzënësisë dhe gjatë lindjes. Për qëllime të krahasimeve kombëtare, lindjet e vdekura janë të definuar si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ( $\geq 500$  g ose  $\geq 22$  javë). Për qëllime të krahasimeve ndërkombëtare, lindjet e vdekura janë të definuar si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ( $\geq 1,000$  g ose  $\geq 28$  javë).

### **Shkalla e vdekshmërisë perinatale**

Numri i vdekjeve perinatale (të lindur të vdekur dhe vdekje të hershme neonatale) e shprehur për 1,000 të lindur gjallë. Organizata Botërore e Shëndetësisë e përcakton vdekshmërinë perinatale si "numrin e lindjeve të vdekura dhe vdekjeve në javën e parë të jetës për 1,000 lindje totale, periudha perinatale fillon në 22 javë të plota (154 ditë) të shtatzënisë, dhe përfundon shtatë ditë të plota pas lindjes".

**Shkalla e vdekshmërisë neonatale (mortaliteti neonatal)** definohet si numri i fëmijëve të lindur të gjallë që vdesin pa i mbushë 28 ditë të jetës (0-27 ditë) e shprehur për 1,000 të lindur të gjallë brenda një viti kalendarik.

**Vdekjet neonatale** (vdekjet gjatë 28 ditëve të para të jetës së foshnjës) mund të ndahen në:

**vdekjet e hershme neonatale**, që ndodhin brenda 7 ditëve (0-6 ditë) të para të jetës,

**vdekjet e vonshme neonatale** që ndodhin pas ditës së 7, (7-27 ditë), por para se të përfundohet dita e 28-të.

### **Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil)**

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave paraqet numrin e foshnjave të vdekura para moshës 1 vjeçare (0-11 muaj) të shprehur për 1,000 të lindur të gjallë, në një periudhë të caktuar kohore. Vdekshmëria e foshnjave paraqet probabilitetin që fëmija të vdesë para se t'i mbushë 1 vjet për 1,000 të lindur të gjallë.

**Shkalla e vdekshmërisë maternale** paraqet numrin e grave të vdekura nga ndonjë shkak që lidhet me (ose është shkaktuar nga) shtatzëninë (duke përjashtuar shkaqe aksidentale apo të rastësishme) dhe vdekjet gjatë lindjes ose brenda 42 ditëve pas përfundimit të shtatzënisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe vendi i shtatzënisë, e shprehur në 100,000 të lindur gjallë, për një periudhë të caktuar kohore.

**Vdekje e vonshme maternale** është vdekja e një gruaje nga shkaqe të drejtpërdrejta ose të tërthorta më shumë se 42 ditë, por më pak se një vit pas përfundimit të shtatzënisë.

## METODOLOGJIA

Për përpilimin e raportit janë përdorur të dhënat për vitin 2023 nga ASK për statistikat vitale si dhe të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe të përpiluara në raporte nga Departamenti i Statistikave Shëndetësore në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK).

Regjistrimi dhe grumbullimi i të dhënave për statistikat vitale janë detajuar sipas institucioneve relevante dhe kompetente në çdo fazë të procesit.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave demografike në nivel nacional. IKShPK, gjegjësisht Departamenti i Statistikave Shëndetësore, grumbullon të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe bën raportimin e fenomeneve vitale përmes raporteve nga institucionet shëndetësore relevante ndërsa Departamenti i Mjekësisë Sociale gjegjësisht Divizioni i Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve bënë analizën e indikatorëve të disagreguar.

ASK është përgjegjës për grumbullimin e të dhënave nëpër hapat si më poshtë: çdo institucion shëndetësor dhe zyrë e gjendjes civile ka plotësuar Fletëzat statistikore për vdekje DEM-2. Në baza mujore, institucionet shëndetësore dhe zyrat e gjendjes civile raportojnë në zyrat regjionale të ASK, duke dorëzuar kopjet fizike të gjitha DEM-2 të plotësuar. Zyrat regjionale të ASK-së, me pasqyrën mujore të të dhënave për lindje dhe vdekje DEM-5, raportojnë në ASK. Departamenti i statistikave sociale – sektori i statistikave vitale në ASK, kontrollon cilësinë dhe konfirmon të gjitha të dhënat të cilat futen në programin Access në Departamentin e IT-së. Sektori i statistikave vitale në ASK kontrollon të dhënat në data bazën e vdekjeve dhe përpunon të dhënat me SPSS. ASK publikon në faqen ueb raportin “Statistikat e vdekjeve”.

Grumbullimin e të dhënave nga institucionet shëndetësore relevante e realizon Departamenti i Statistikave Shëndetësore në IKShPK, kalkulimin e indikatorëve të disagreguar sipas gjinisë, komunave, moshës si dhe prezantimin e trendit e realizon, Departamenti i Mjekësisë Sociale, Divizioni i Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve.

## **Sfidat në grumbullimin e të dhënave:**

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) një nga sfidat kryesore është mungesa e pyetësorit të standardizuar nga tri institucionet (Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Ministria e Shëndetësisë, IKShPK) dhe sidomos digjitalizimi i gjithë procesit.

Gjatë vitit 2019/2020 është punuar në unifikimin e formularit për raportim, megjithatë të dhënat nga ASK për vitin 2024 për lindje dhe vdekje nuk janë të kompletuara edhe pas publikimit të fundit, prandaj në raportin e gjendjes Perinatale për vitin 2024, në mungesë të të dhënave disa indikatorë të agreguar kanë diskrepancë krahasuar me vitet paraprake si dhe disa indikatorë tjerë nuk kemi mundësi t'i kalkulojmë sipas gjinisë dhe komunave.

Numri i banorëve është bazuar në regjistrimin e fundit të popullatës, 2024 (ASK).

Përkundër ekzistimit në fuqi të qarkores për raportim të vdekjeve maternale, si dhe kërkesës së vazhdueshme ndër vite për raportim edhe në vitin 2024 asnjë vdekje maternale nuk është raportuar nga institucionet shëndetësore, andaj edhe në vitin 2024 në mungesë të të dhënave nuk ka reflektim të këtij indikatorit në Raportin e Gjendjes Perinatale.

Përfshirja në raportim e vdekjeve fetale sipas komunave të Kosovës është sfidë tjetër për t'u adresuar pasi që nuk ka të dhëna nga ASK.

Mungesa e publikimit me kohë të shkaqeve të vdekjeve për vitin 2024 në nivel nacional reflektohet në ndërmarrjen e masave intervenuese.

Mortaliteti perinatal ndikohet prej faktorëve tjerë jashtë sistemit shëndetësor dhe jo vetëm brenda kujdesit shëndetësor.

Në Raportin Perinatal për vitin 2024 janë përfshirë vetëm disa prej indikatorëve bazik dhe vazhdon të mbetet sfidë për Kosovën gjenerimi i indikatorëve të shëndetit perinatal sipas instrumentit Evropian EURO-PERISTAT.

## TË DHËNAT KRYESORE

Të dhënat perinatale kryesore për vitin 2024 në Kosovë (Tab.1,2), të raportuara nga institucionet shëndetësore publike dhe private në Departamentin e Statistikave Shëndetësore - IKShPK janë:

- 20,661, lindje (lehona)
- 21,091, foshnje të lindura
- 20,973, të lindur të gjallë
- 118 të lindur të vdekur
- raporti gjinor në lindje është 999.3 meshkuj në 1,000 femra (shkalla e maskulinitetit)
- përqindja e lindjeve me prerje cezariane është 46.2%.

**Tabela 1. Të dhënat kryesore perinatale për vitin 2024**

Nr.	Modalitetet	2024
1	Numri i të porsalindurve të lindur të gjallë	21,487
2	Numri i vdekjeve fetale	118
3	Numri i foshnjave të vdekura (<1 vjet)	126
4	Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	5.5
5	Shkalla e vdekshmërisë infantile (‰)	5.9
6	Numri i foshnjave të vdekura në javën e parë	95
7	Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	4.4
8	Shkalla e mortalitetit të vonshëm neonatal (‰)	0.8
9	Shkalla e mortalitetit post neonatal (‰)	0.6
10	Shkalla e vdekshmërisë perinatale (‰)	9.9
11	Përqindja e lindjeve me prerje cezariane (%)	46.2

Burimi: ASK- Statistikat e lindjeve, vdekjeve, 2024

Departamenti i Statistikave Shëndetësore- IKShPK, Statistikat e lindjeve, 2024

**Tabela 2. Të dhënat kryesore perinatale për periudhën, 2000-2024**

Vitet	Të dhënat kryesore perinatale, 2000-2024							
	Numri i lindjeve	Numri i të porsalindurve të lindur të gjallë	Numri i vdekjeve fetale	Shkalla e vdekshmëri së fetale (‰)	Numri i foshnjeve të vdekura në javën e parë	Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	Shkalla e vdekshmëri së perinatale (‰)	Shkalla e lindjeve me prerje cezaria ne (%)
2000	39,091	38,907	572	14.5	577	14.8	29.1	7.5
2001	39,578	39,506	579	14.4	574	14.5	28.7	9.1
2002	35,399	35,271	527	14.7	444	12.6	27.1	10.3
2003	31,932	31,815	517	15.9	375	11.8	27.6	11.3
2004	30,925	30,852	452	14.4	352	11.4	25.6	12.3
2005	29,056	29,055	390	13.3	262	9.02	22.1	13.9
2006	28,404	28,450	360	12.5	307	10.8	23.2	16.4
2007	27,856	27,972	319	11.3	247	8.8	20.0	17.7
2008	28,178	28,317	334	11.6	257	9.1	20.6	18.2
2009	27,718	27,833	276	9.8	267	9.6	19.3	20.1
2010	27,517	27,645	318	11.4	216	7.8	19.1	20.7
2011	27,548	27,725	252	9.0	248	8.9	17.9	21.8
2012	28,525	28,664	284	9.8	218	7.6	17.3	20.9
2013	27,069	27,277	278	10.1	170	6.2	16.3	25.2
2014	26,565	26,787	226	8.4	98	3.7	12.0	26.9
2015	24,611	24,812	177	7.1	126	5.0	12.1	27.3
2016	24,092	24,697	156	6.3	121	4.9	11.2	24.3
2017	23,563	23,402	161	6.8	132	5.6	12.4	19.0
2018	22,870	22,761	109	4.8	147	6.6	11.2	18.2
2019	21,899	21,798	101	4.6	118	5.4	10.0	20.7
2020	20,781	20,988	135	6.4	43	1.9	8.0	21.0
2021	20,654	22,830	116	5.1	64	2.8	7.9	26.5
2022	20,165	22,632	133	6.5	82	3.6	10	29.2
2023	19,566	21,654	112	5.7	88	4.1	9.8	40.5
2024	20,661	21,487	118	5.5	95	4.4	9.9	46.2

Burimi: Raporti i gjendjes perinatale, 2010

ASK: Statistikat e lindjeve dhe vdekjeve, 2011-2024 Departamenti i Statistikave Shëndetësore- IKShPK

## LINDJET

Në vitin 2024, sipas të dhënave të statistikave të lindjeve (ASK), janë raportuar gjithsej 21,487 të lindur gjallë, prej tyre 489 të lindur jashtë Kosovës, ndërsa mungojnë të dhënat për të lindur të vdekur (Tab.1 dhe 2).

Sipas IKShPK-së janë raportuar gjithsej 20,661 lindje (lehona), me 21,091 foshnje të lindura, 20,973 të lindur të gjallë dhe 118 të lindur të vdekur. Numri i të lindurve të gjallë më i lartë se numri i lehonave (lindjeve) shpjegohet me faktin se disa nga lindjet kanë qenë me bineq.

Diferenca e numrit të të lindurve të gjallë të raportuar nga ASK dhe IKShPK për vitin 2024 është 514 të lindur të gjallë, kjo ndodhë me vite të tëra për arsye të mos unifikimit të mbledhjes së të dhënave në mes ARC, ASK dhe institucioneve shëndetësore, problem ky i ngritur nga IKSHPK me vite të tëra. (Tab.3).

**Tabela 3. Raportimi i të dhënave nga dy burime të të dhënave**

Institucioni	Foshnje të lindur gjallë	Të lindur vdekur
ASK	21,487	Nuk ka të dhëna të raportuara
IKShPK	20,973	118
Diferenca	514	(mungon raportimi i rasteve të të lindurve të vdekur në ASK)

Burimi: ASK: Statistikat e Lindjeve 2024

IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore: Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2024

Bazuar në raportin e IKShPK- së, për vitin 2024 gjithsej ishin 20,661 lindje. Sipas nivelit të kujdesit shëndetësor ku janë kryer lindjet, të dhënat janë si në vijim: përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në Spitalet e përgjithshme me 9,535 apo 46.1%, pason Klinika Obstetrike Gjinekologjike e QKUK-së me 7,648 lindje apo 37.1%, në maternitete 60 lindje apo 0.3%, ndërsa në spitalet private (Amerikan, Lindja, Kestrina, Dream Hospital, Sirona, European Clinic, Behar Kusari dhe Fati im) 3,418 lindje apo 16.5%.

Në institucionet publike janë realizuar gjithsej 17,243 apo 83.5% e lindjeve, (Tab.4,5).

**Tabela 4. Lindjet në institucione shëndetësore sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, Kosovë - 2024**


Institucioni	Gjithsej lindje (Lehona)		Gjithsej foshnje të lindura		Prej tyre të lindura gjallë		Prej tyre të lindura pa jetë	
	N	%	N	%	N	%	N	%
QKUK	7,648	37.1	7,892	37.4	7,811	37.2	81	68.6
Spitali	9,535	46.1	9,630	45.7	9,601	45.8	29	24.6
Maternitetet jashtë spitalore	60	0.3	60	0.3	60	0.3	0	0.0
Institucione publike	17,243	83.5	17,582	83.4	17,472	83.3	110	93.2
Institucione private	3,418	16.5	3,509	16.6	3,501	16.7	8	6.8
<b>Gjithsej</b>	<b>20,661</b>	<b>100.0</b>	<b>21,091</b>	<b>100.0</b>	<b>20,973</b>	<b>100.0</b>	<b>118</b>	<b>100.0</b>

Burimi: IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2024

**Tabela 5. Lindjet në maternitetet jashtë spitalore në nivelin parësor shëndetësor, Kosovë – 2024**

Komuna	Lindje (lehona)		Foshnje të lindura		Prej tyre të lindura gjallë		Të lindura të vdekura	
	N	%	N	%	N	%	N	%
Deçan	0		0		0		-	-
Dragash	-		-		-		-	-
Drenas	8	0.04	8	0.04	8	0.04	-	0
Istog	-		-		-		-	-
Kamenicë	-		-		-		-	-
Klinë	-		-		-		-	-
Lipjan	-		-		-		-	-
Malishevë	-		-		-		-	-
Podujevë	7	0.03	7	0.03	7	0.03	-	0
Rahovec	42	0.2	42	0.2	42	0.2	-	0
Skenderaj							-	-
Suharekë	3	0.01	3	0.01	3	0.01	-	0
Viti	0		0		0		-	-
Kaçanik	0		0		0		-	-
	<b>60</b>	<b>0.3</b>	<b>60</b>	<b>0.3</b>	<b>60</b>	<b>60</b>	<b>-</b>	<b>0</b>

Burimi: IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2024




**Graf.1 Struktura e lindjeve në institucionet publike dhe private, 2024**

Burimi: IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2024

**Tabela 6. Të lindurit gjallë sipas gjinisë, shkalla e maskulinitetit**

Institucioni	Komuna	Gjinia				TOTALI		Shkalla e maskulinitetit në 1000
		Djem		Vajza		N	%	
		N	%	N	%			
<b>TOTALI</b>		10,483	50.0	10,490	50.0	20,973	100.0	999.3‰

Burimi: IKShPK - Lindjet në institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2024




**Graf.2. Struktura e të lindurve gjallë sipas gjinisë**

Burimi: IKShPK - Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2024

Sipas të dhënave nga Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2024 gjithsej ishin 20,973 të lindur të gjallë prej tyre, femra 10,490 (50.0%), meshkuj 10,483 (50.0%) me koeficient të maskulinitetit në lindje 999.3%, (Tab.6, Graf.2).

Sipas të dhënave nga ASK, komunat me më së shumti të lindur të gjallë ishin: Komuna e Prishtinës me 2,870 apo (13.3%), Komuna e Prizrenit me 1,858 apo (8.6%) dhe Komuna e Ferizajt me 1,459 apo (6.8%). Komunat me numrin më të vogël të të lindurve të gjallë (me 0.1%) ishin: Komuna e Parteshit, Ranillugës dhe Klllokotit, (Graf.3).




**Graf.3. Struktura (%) e të lindurve gjallë sipas komunave, 2024**

Burimi: ASK-Statistikat e Lindjeve, 2024

## Trendi i lindjeve

Trendi i lindjeve për periudhën kohore 2000-2024 tregon ecuri të rënies së numrit të lindjeve me lëvizje variabile me mesatare 0.9 %, (Graf.4).




**Graf.4. Trendi i lindjeve, Kosovë 2000-2024**

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2024

## Trendi i natalitetit


Lindshmëria gjatë viteve 2000-2024 tregon trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare 0.6%. Lindshmëria për 1,000 banorë apo nataliteti në vitin 2000 ishte 19.3%, ndërsa në vitin 2024 ishte 13.6 %, (Graf.5).



**Graf.5. Trendi i natalitetit, Kosovë 2000-2022**

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë

Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti ishte në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së me 21.4 lindje në ditë, pason Prizreni me 6.6 lindje, Mitrovica me 4.5 lindje, Gjakova me 4.3 lindje dhe Peja me 3.9 lindje, më së paku lindje në Vushtrri me 0.3 lindje në ditë. (Graf.6).



**Graf.6. Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore**


Burimi: IKShPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2024

Sa i përket të porsalindurve sipas peshës trupore në lindje me pjesëmarrje më të madhe ishte grup pesha 2,500-3,999g me 87.4 % dhe grup pesha 4,000+g me 8.1 %. Pjesëmarrje më të vogël në lindje kishte grup pesha më pak se 1,000g me 0.4%. Pesha mesatare e të porsalindurve gjallë ishte 3,323.9 gram, (Tab.7, Graf.7).

**Tabela 7. Numri i foshnjave të lindura gjallë sipas peshës trupore në gram, në institucionet publike dhe private, në vitin 2024**

Institucioni	Komuna/ Institucioni	Pesha trupore në gram					Gjithsej	Pesha mesatare
		Nën 1,000	1,000-1,499	1,500-2,499	2,500-3,999	4,000+		
TOTALI	N	91	184	664	18,293	1,699	20,931	3,323.9
	%	0.4	0.9	3.2	87.4	8.1	100.0	

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2024



**Graf.7. Përqindja e foshnjave të lindura gjallë sipas grup peshave për vitin 2024**

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2024

Sipas grup-moshës së nënës pjesëmarrja më e lartë e të lindurve të gjallë ishin nga nënat e grup moshës 25-29 vjet me 6,940 apo 32.3%, pasojnë të lindurit gjallë nga nënat e grup moshës 30-34 vjet me 6,581 apo 30.6%. Moshja mesatare e nënave ishte 29 vjet, (Tab.8).

**Tabela 8. Të lindurit gjallë sipas grup-moshave të nënës sipas, 2024**

Grup moshë e nënës sipas viteve										Mosha mesatare	
14 e më pak	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50 e më shumë	Gjithsej		
N	1	337	3,439	6,940	6,581	3,265	783	125	16	21,487	29
%	0.0	1.6	16.0	32.3	30.6	15.2	3.6	0.6	0.1	100.0	

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2024

Në vitin 2024 sipas të dhënave të ASK-së nga gjithsej 21,487 të lindur gjallë, 20,720 apo 96.4% prej tyre kishin lindur nga një foshnje, 767 apo 3.6% kanë lindur binjak dhe nuk është raportuar asnjë lindje trinjake, (Tab.9).

**Tabela 9. Foshnje të lindura sipas numrit**

<b>Fëmijë të lindur</b>	<b>N</b>	<b>%</b>
Një	20,720	96.4
Binjak	767	3.6
Trenjak	0	0.0
<b>Gjithsej</b>	<b>21,487</b>	<b>100.0</b>

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2024

Në institucionet shëndetësore publike dhe private nga gjithsej 20,661 lindje të raportuara, 9,546 prej tyre apo 46.2% janë realizuar me prerje cezariane, lindje normale gjithsej ishin 11,115 apo 53.8%, (Tab.10, Graf.8.).


Në institucionet publike nga gjithsej 17,243 lindje, lindje normale janë realizuar 10,534 apo 61.1%, lindje me prerje cezariane 6,709 apo 38.9%.

Në institucionet private nga gjithsej 3,418 lindje, 581 apo 17.0% janë lindje normale, lindje me prerje cezariane janë realizuar 2,837 apo 83.0%, (Tab.10,11, Graf.7).

**Tabela 10. Struktura e lindjeve sipas mënyrës së lindjes në institucionet publike dhe private, 2024**

<b>Mënyra e Lindjes</b>	<b>N</b>	<b>%</b>
Lindje normale	11,115	53.8
Lindje me prerje cezariane	9,546	46.2
<b>Gjithsej lindje</b>	<b>20,661</b>	<b>100.0</b>

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës, 2024




**Graf.8. Struktura e lindjeve sipas mënyrës së lindjes, për vitin 2024**

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës, 2024

Në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së, 3,121 apo 40.8% e lindjeve janë me prerje cezariane. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariane ishte realizuar në spitalin e Pejës me 661 raste apo 47.6%, pason spitali i Gjilanit me 535 raste apo 41.5% dhe spitali me më pak raste të raportuara të lindjeve me prerje cezariane ishte spitali i Ferizajt me 234 raste apo 18.9%.

Në spitalet private, nga gjithsej 3,418 lindje të raportuara 2,837 apo 83.0% prej tyre janë realizuar me prerje cezariane, (Tab.11, Graf.9).



**Graf.9. Struktura e lindjeve sipas mënyrës së lindjes në dhe llojit të institucioneve shëndetësore**


Burimi: IKShPK – Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës për vitin 2024

**Tab.11. Lindjet me prerje Cezariane sipas institucioneve shëndetësore, Kosovë 2024**

Institucioni		Komuna	Lindje me prerje cezariane		Gjithsej Lindje
			N	%	N
<b>Institucionet Publike</b>	QKUK	Prishtinë	3,121	40.8	7,648
	Spitali i Përgjithshëm	Ferizaj	234	19.7	1,187
	Spitali i Përgjithshëm	Gjakovë	514	33.2	1,549
	Spitali i Përgjithshëm	Gjilan	535	41.5	1,288
	Spitali i Përgjithshëm	Mitrovicë	636	39.1	1,627
	Spitali i Përgjithshëm	Pejë	661	47.6	1,390
	Spitali i Përgjithshëm	Prizren	968	40.6	2,383
	Spitali i Përgjithshëm	Vushtrri	40	36.0	111
	Maternitete jashtë spitalore			0	0.0
<b>Gjithsej në Institucione Publike</b>			<b>6,709</b>	<b>38.9</b>	<b>17,243</b>
<b>Institucionet Private</b>	Spitali Amerikan	Prishtinë	458	98.5	465
	Klinika Amerikane "Behar Kusari"	Prishtinë	1,083	85.9	1,261
	Spitali "Fati im"	Prishtinë	654	85.5	765
	Spitali Lindja	Prishtinë	282	76.6	368
	Spitali European Clinic	Gjakovë	97	65.1	149
	Spitali Dream Hospital	Ferizaj	193	57.3	337
	Spitali Kestrina	Prishtinë	70	95.9	73
<b>Gjithsej në Institucione Private</b>			<b>2,837</b>	<b>83.0</b>	<b>3,418</b>
<b>TOTALI</b>			<b>9,546</b>	<b>46.2</b>	<b>20,661</b>

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës për vitin 2024

Në Graf.10 është analizuar ecuria e lindjeve me prerje cezariane për periudhën 2000-2024, ku shihet se lindjet me prerje cezariane kanë pësuar rritje përgjatë viteve, sidomos në vitin 2015 ishte përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariane (27.3%), pason një rënie në vitin 2017, 2018 dhe prapë kemi ngritje të theksuar në vitin 2023 me 40.5% dhe 2024 me 46.2%.



**Graf.10. Struktura e lindjeve me prerje cezariane për vitet, 2000-2024**

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës

## VDEKSHMËRIA E FOSHNJAVE

### Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil)

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave paraqet numrin e foshnjave të vdekura para moshës 1 vjeçare (0-364 ditë) të shprehur për 1,000 të lindur të gjallë, në një periudhë të caktuar kohore.

Vdekshmëria e foshnjave apo mortaliteti infantil përfaqëson një ndër treguesit më të rëndësishëm të shëndetit publik dhe zhvillimit social-ekonomik të një vendi. Ky indikator reflekton në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën, qasjen në shërbime shëndetësore, si dhe faktorët socio-ekonomikë dhe mjedisorë që ndikojnë në mbijetesën e foshnjave gjatë vitit të parë të jetës.

Në Kosovë, vdekshmëria e foshnjave mbetet një sfidë e rëndësishme për sistemin shëndetësor, pavarësisht përmirësimeve të shënuara gjatë viteve të fundit. Kjo është e lidhur me faktorë të shumtë si: lindjet e parakohshme, mungesa e kujdesit cilësor prenatal dhe postnatal, infeksionet, kequshqyerja, si dhe mungesa e edukimit shëndetësor në komunitet. Veçanërisht në zonat rurale dhe në grupet vulnerabile, qasja në shërbime shëndetësore mbetet e kufizuar, duke ndikuar në rritjen e riskut për vdekshmëri të hershme tek foshnjat.

Monitorimi dhe analizimi i këtij treguesi ka rëndësi të madhe për hartimin e politikave të qëndrueshme shëndetësore dhe ndërhyrjeve efektive në fushën e kujdesit për shëndetin e nënës dhe fëmijës.


Vdekshmëria infantile kërkon qasje shumë sektoriale, investime në infrastrukturën shëndetësore, ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit mjekësor, si dhe edukim e ndërgjegjësim të komunitetit për kujdesin gjatë shtatzënisë dhe në periudhën e hershme të jetës së fëmijës.

Sipas të dhënave nga ASK, gjatë vitit 2024 institucionet shëndetësore kanë raportuar gjithsej 126 foshnje të vdekura, prej tyre 95 apo (75.4%) ishin foshnje të vdekura prej 0-6 ditë, 18 apo (14.3%) ishin foshnje të vdekura prej 7-27 ditë dhe 13 apo (10.3%) foshnje të vdekura prej 1-11 muaj. (Tab.12,13, Graf.11).

**Tab.12. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës**

Foshnje të vdekura	Deri në 24 orë	1 – 6 ditë	7 – 27 ditë	1 – 11 muaj	Gjithsej
N	49	46	18	13	126
%	38.9	36.5	14.3	10.4	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2024



**Graf.11. Struktura e vdekshmërisë së foshnjave sipas moshës**

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2024


**Tab.13. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës dhe gjinisë**

Gjinia	Gjithsej	Moshja e foshnjave të vdekura		
		0-6 ditë	7-27 ditë	28-364 ditë
Meshkuj	69	54	9	6
Femra	57	41	9	7
Gjithsej	126	95	18	13
%	100	75.4	14.3	10.3

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2024

Mortaliteti infantil në vitin 2024 ishte 5.9%, kurse në vitin paraprak vlera e këtij indikatorit ishte 5.7%.


Shkalla e mortalitetit infantil për periudhën 2002-2024 tregon rënie me lëvizje variabile me mesatare prej 0.6%, (Graf.12).



**Graf.12. Mortaliteti infantil, 2002-2024**


Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2024

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave sipas moshës për vitin 2024 është si vijon: Mortaliteti neonatal i hershëm 4.4%, mortaliteti neonatal i vonshëm 0.8% dhe mortaliteti post neonatal 0.6%, (Graf.13).



**Graf.13. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës**


Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2024



**Graf.14. Vdekshmëria e foshnjave sipas gjinisë**

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2024

Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale në vitin 2024 ishte 4.4%, ndërsa në vitin 2023 ishte 4.1%. Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale për vitet 2000-2024 ka pësuar rënie me lëvizje variable me mesatare prej 0.9% (Graf.15).



**Graf.14. Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale**

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2024

Në vitin 2024 nga gjithsej 126 foshnje të vdekura, 69 prej tyre janë meshkuj dhe 57 femra. Numri më i madh i vdekshmërisë së foshnjave sipas moshës së nënës ishte mosha 25-34 vjet me 67 foshnje të vdekura, (Tab.14) si dhe numri më i madh i foshnjave të vdekura sipas statusit martesor ishte te nënat e martuara me 93 raste (Tab.15)

**Tabela 14. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës së nënës**

Grup moshë e nënës (vj.)		Gjithsej	Moshë e foshnjave të vdekura		
			0-6 ditë	7-27 ditë	28-364 ditë
Grup moshë	15-24	22	16	4	2
	25-34	67	50	9	8
	35+	37	29	5	3
<b>Gjithsej</b>		126	95	18	13
<b>%</b>		<b>100.0</b>	<b>75.4</b>	<b>14.3</b>	<b>10.3</b>

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2024

**Tabela 15. Vdekshmëria e foshnjave sipas statusit martesor të nënës**

Statusi martesor i nënës		Moshë e foshnjave të vdekura				
		Gjithsej	0-6 ditë	7-27 ditë	28-364 ditë	
Statusi martesor i nënës	E pamartuar	32	27	2	3	
	E martuar	93	67	16	10	
	E ve	0	0	0	0	
	E shkurorëzuar	1	1	0	0	
	<b>Gjithsej</b>		<b>126</b>	<b>95</b>	<b>18</b>	<b>13</b>
	<b>%</b>		<b>100.0</b>	<b>75.4</b>	<b>14.3</b>	<b>10.3</b>

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2024

## VDEKSHMËRIA FETALE

Vdekshmëria fetale paraqet numrin e të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur gjallë (të lindur të vdekur në raport me të lindur të gjallë). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes, gjatë shtatzënësisë dhe gjatë lindjes.


Në vitin 2024 sipas IKShPK-së, departamentit të Statistikave Shëndetësore, numri i foshnjave të lindura pa jetë në institucionet publike dhe private ka qenë 118, me vdekshmëri fetale 5.5%. Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 81 vdekje fetale apo 68.6% kanë ndodhë në QKUK, 29 apo 24.6% në spitale, në institucione private janë raportuar 8 raste të lindura pa jetë apo 6.8%, (Tab.16).

**Tab.16. Foshnjat e lindura pa jetë sipas institucioneve shëndetësore, 2024**

Institucioni	Të lindur pa jetë	
	N	%
QKUK	81	68.6
Spitalet e përgjithshme	29	24.6
Maternitetet jashtë spitalore	0	0.0
Institucionet publike	110	93.2
Institucionet private	8	6.8
<b>Gjithsej</b>	<b>118</b>	<b>100.0</b>

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2024


Sipas të dhënave të raportuara në departamentin e Statistikave Shëndetësore, në nivelin terciar në QKUK, në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, vdekshmëria fetale është më e larta me 3.8%. Sa i përket spitaleve rajonale, spitalet me shkallën më të lartë të vdekshmërisë fetale janë: spitali i Gjakovës me 0.4%, Pejë dhe Prizrenit me nga 0.3%. Spitali i Vushtrrisë nuk ka raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale (Graf.15).



**Graf.15. Vdekshmëria fetale (%) sipas institucioneve shëndetësore publike**

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2024

Vdekshmëria fetale për periudhën 2000-2024 ka trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.7%. Në vitin 2000 shkalla e vdekshmërisë fetale ishte 14.5% ndërsa në vitin 2024 është 5.5%, krahasuar me vitin paraprak (5.7%) kemi rënie të lehtë (Graf.16).



**Graf.16. Shkalla e vdekshmërisë fetale, 2000-2024**


Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2024

## VDEKSHMËRIA PERINATALE

Vdekshmëria perinatale pasqyron vdekshmërinë fetale dhe vdekshmërinë e hershme neonatale së bashku për një periudhë të caktuar kohore në territor të caktuar. Ky indikator reflekton cilësinë e kujdesit shëndetësor për nënat dhe të porsalindurit. Rëndësia e gjendjes perinatale qëndron në reflektimin e gjendjes shëndetësore të vendit dhe cilësinë e sistemit shëndetësor.

Në vitin 2024 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 9.9% (vdekshmëria fetale 5.5% dhe vdekshmëria e hershme neonatale 4.4%), kurse në vitin paraparak ishte 9.8%.

Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2000-2024 tregon tendencë të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.9%, (Graf.17).



**Graf.17. Trendi i mortalitetit perinatal, 2000-2024**

Burimi: Raporti i gjendjes perinatale, 2010

ASK, Statistikat e Vdekjeve dhe lindjeve 2000-2024

**Tab.17. Indikatorët demografikë në Kosovë sipas komunave, 2024**

<b>Komuna</b>	<b>Banorë</b>	<b>Nataliteti</b>	<b>Mortaliteti</b>	<b>Mortaliteti infantil</b>	<b>Shtimi natyror</b>
Deçan	27,775	11.2	7.7	6.4	3.5
Gjakovë	78,699	13.1	7.4	7.8	5.7
Glllogoc	48,079	16.3	5.6	5.1	10.7
Gjilan	82,980	12.9	7.5	2.8	5.4
Dragash	28,896	7.9	6.7	0.0	1.2
Istog	33,008	11.6	7.9	2.6	3.7
Kaçanik	27,716	15.2	5.5	2.4	9.7
Klinë	30,503	14.5	7.0	4.5	7.6
Fushë Kosovë	63,949	12.6	3.7	10.0	8.9
Kamenicë	22,868	10.5	9.8	4.1	0.8
Mitrovicë Jugore	64,742	12.4	7.0	6.3	5.3
Leposaviq	3,185	11.6	15.7	0.0	-4.1
Lipjan	55,044	14.4	5.1	7.6	9.3
Novobërdë	4,493	19.1	12.7	0.0	6.5
Obiliq	22,815	16.7	6.8	5.2	9.9
Rahovec	41,799	13.3	6.5	5.4	6.8
Pejë	82,745	11.6	7.1	3.1	4.5
Podujevë	70,975	15.1	6.3	11.2	8.8
Prishtinë	227,466	12.6	5.1	7.0	7.6
Prizren	147,246	12.6	6.4	4.8	6.2
Skenderaj	40,664	14.6	7.8	6.7	6.9
Shtime	24,308	15.6	4.9	7.9	10.7
Shtërpçë	10,771	10.2	8.4	9.1	1.9
Suharekë	45,749	11.9	6.9	11.0	5.0
Ferizaj	109,255	13.4	5.3	6.2	8.0
Viti	35,566	14.8	6.4	1.9	8.4
Vushtrri	61,528	14.9	6.6	9.8	8.3
Zubin Potok	763	59.0	41.9	0.0	17.0
Zveçan	434	82.9	96.8	0.0	-13.8
Malishevë	43,888	16.0	5.5	4.3	10.5
Junik	3,943	9.9	7.4	0.0	2.5
Mamushë	5,607	13.6	4.1	0.0	9.5
Hani i Elezit	8,533	11.7	5.0	0.0	6.7
Graçanicë	18,486	8.2	6.2	0.0	2.0
Ranillug	2,481	8.5	10.9	0.0	-2.4
Partesh	3,240	8.0	10.8	0.0	-2.8
Kllokot	3,041	9.2	5.3	0.0	3.9
Mitrovicë Veriore	2,326	44.3	33.5	0.0	10.7
Jashtë Kosove		0.0	0.0	0.0	0.0
<b>Gjithsej</b>	<b>1,585,566</b>	<b>13.6</b>	<b>6.4</b>	<b>5.9</b>	<b>7.2</b>

Burimi: ASK: Regjistrimi i popullatës, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, 2024  
 Statistikat e Lindjeve dhe Statistikat e Vdekjeve, 2024

## PËRFUNDIMET

Në vitin 2024, është evidentuar përsëri mospërputhje në raportimin e të dhënave për lindje, si rezultat i mungesës së unifikimit të formularëve ndërmjet institucioneve përkatëse. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) raportoi gjithsej 21,487 foshnja të lindura gjallë, nga të cilat 489 jashtë vendit. Departamenti i Statistikave Shëndetësore (DShS) në IKSHPK raportoi 20,973 lindje të gjalla dhe 118 lindje të vdekura.

### Struktura e lindjeve sipas institucioneve

Spitalet e përgjithshme: 9,535 lindje (46.1%)

Klinika Obstetrike Gjinekologjike e QKUK-së: 7,648 lindje (37.1%)

Spitalet private (Amerikan, Lindja, Kestrina, Dream Hospital, Sirona, European Clinic, Behar Kusari dhe Fati Im): 3,418 lindje (16.5%)

Maternitetet: 60 lindje (0.3%)

Në total, 83.5% e lindjeve janë realizuar në institucionet publike, ndërsa 16.5% në ato private. Numri shumë i ulët i lindjeve në maternitete tregon mungesë shfrytëzimi të kapaciteteve ekzistuese.

### Lindjet e realizuara me prerje cezariene

Në vitin 2024, 46.2% e lindjeve janë kryer me prerje cezariene, duke shënuar një rritje prej 5.6% krahasuar me vitin paraprak (40.5%). Ky trend është veçanërisht i theksuar në institucionet private, duke ngritur shqetësime për përdorimin e tepruar të kësaj procedure.

### Ecuria e lindshmërisë për periudhën (2000-2024)

Në periudhën 2000-2024, ka pasur rënie të vazhdueshme të numrit të lindjeve, me një mesatare prej 0.9%, që lidhet me faktorë socio-ekonomikë dhe ndryshime kulturore.

### Karakteristikat e të lindurve

Nga numri total i të lindurve gjallë 87.4% e foshnjave kishin peshë trupore normale (2,500-3,999 gram), foshnjat <1,000 gram përbënin vetëm 0.4%. Pesha mesatare e të lindurve të gjallë ishte 3,323.9 gram. Mosha mesatare e nënave ishte 29 vjeç.

### **Mortaliteti infantil**

Në vitin 2024 sipas të dhënave të ASK, u raportuan 126 foshnja të vdekura:

0–6 ditë: 95 raste (75.4%)

7–27 ditë: 18 raste (14.3%)

1–11 muaj: 13 raste (10.3%)

Mortaliteti infantil në vitin 2024 ishte 5.9‰, me ndarjen sipas moshës: Neonatal i hershëm: 4.4‰, neonatal i vonshëm: 0.8‰, postneonatal: 0.6‰. Në periudhën 2000-2024, mortaliteti infantil ka shënuar rënie të qëndrueshme me mesatare 0.5‰). Mortaliteti perinatal në vitin 2024 ishte 9.9‰, për periudhën 2000-2024 tregon tendencë të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.9‰.

## REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË

- Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) dhe Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) të standardizojnë procedurat e raportimit të të dhënave, të implementojnë formularë të unifikuar për mbledhjen e të dhënave perinatale, në bashkëpunim me MSh dhe IKSHPK.
- Të sigurohet që të dhënat e raportuara nga komunat dhe institucionet shëndetësore të jenë të plota dhe të harmonizuara për analiza kombëtare.
- Të organizohen trajnime për personelin shëndetësor mbi kodimin e saktë të shkaqeve të vdekjeve, sipas standardeve ndërkombëtare dhe publikimi i tyre të bëhet me kohë me qëllim të analizës së shkaqeve të vdekjeve në këtë raport.
- Ministria e Shëndetësisë në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 11/2013 të obligojë të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private të raportojnë të dhënat perinatale sipas komunave.
- Ministria e Shëndetësisë të obligojë institucionet shëndetësore të respektojnë mekanizmin e raportimit të rregullt dhe të plotë mbi vdekjet maternale dhe shkaqet e vdekjeve të foshnjave.
- Institucionet shëndetësore relevante të krijojnë mekanizma për raportim obligativ të aborteve sipas diagnozave.
- Të fuqizohet qasja multidisiplinare në përmirësimin e kujdesit prenatal dhe natal, në përputhje me pakon e OBSH-së “Every Newborn Action Plan”.
- Të hartohen udhërrëfyes dhe protokolle klinike për kujdesin e nënës dhe foshnjës dhe të monitorohet zbatimi i tyre në praktikë.
- Të realizohet vlerësimi i cilësisë së institucioneve që ofrojnë kujdes për nënën dhe fëmijën. Planifikimi dhe përmirësimet të bazohen në gjetjet e vlerësimit të performancës së këtyre institucioneve.
- Të fuqizohet edukimi i vazhdueshëm profesional i stafit shëndetësor.
- Të përmirësohet infrastruktura, pajisjet mjekësore dhe furnizimi me barna në të gjitha institucionet që ofrojnë kujdes perinatal.
- Të zbatohet Programi i vizitave në shtëpi për nënat dhe fëmijët në të gjitha komunat e Kosovës, si dhe të bëhet monitorimi i rregullt i tyre.

- Të organizohen takime të rregullta profesionale multidisiplinare për prezantimin dhe diskutimin e çështjeve që lidhen me shëndetin e nënës dhe fëmijës.
- Të forcohet koordinimi ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale, si dhe bashkëpunimi me organizata qeveritare, joqeveritare, vendore e ndërkombëtare, dhe shoqërinë civile.
- Të punohet në ngritjen e nivelit të njohurive për shëndetin e nënës dhe fëmijës përmes programeve dhe aktiviteteve të promovimit dhe edukimit shëndetësor në Kosovë.
- Të përkrahet edukimi shëndetësor për shtatzënat, prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes.

## BIBLIOGRAFIA

1. IKSHPK, Raporti i lindjeve në institucionet shëndetësore për vitin 2024
2. ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2024
3. ASK, Statistikat e Vdekjeve në Kosovë, 2024
4. ASK, regjistrimi i popullsisë së Kosovës, 2024
5. Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë, 2010
6. Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë, 2012
7. Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë, 2016
8. Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë, 2017
9. Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë, 2018
10. Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë, 2019
11. Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë, 2020
12. Raporti i gjendjes perinatale, 2021
13. Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë, 2022
14. Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë, 2023

# SHTOJCË

## Të dhënat demografike, 2024, Kosovë

Komuna	Banorë	Lindur gjallë	Vdekur	Vdekje më pak se 1 vit	Nataliteti	Mortaliteti	Mortaliteti infantil	Shtimi natyror
Deçan	27,775	311	215	2	11.2	7.7	6.4	3.5
Gjakovë	78,699	1,031	582	8	13.1	7.4	7.8	5.7
Glllogoc	48,079	782	268	4	16.3	5.6	5.1	10.7
Gjilan	82,980	1,074	626	3	12.9	7.5	2.8	5.4
Dragash	28,896	228	193	0	7.9	6.7	0.0	1.2
Istog	33,008	383	261	1	11.6	7.9	2.6	3.7
Kaçanik	27,716	421	153	1	15.2	5.5	2.4	9.7
Klinë	30,503	443	212	2	14.5	7.0	4.5	7.6
Fushë Kosovë	63,949	804	238	8	12.6	3.7	10.0	8.9
Kamenicë	22,868	241	223	1	10.5	9.8	4.1	0.8
Mitrovicë Jugore	64,742	800	456	5	12.4	7.0	6.3	5.3
Leposaviq	3,185	37	50	0	11.6	15.7	0.0	-4.1
Lipjan	55,044	793	283	6	14.4	5.1	7.6	9.3
Novobërdë	4,493	86	57	0	19.1	12.7	0.0	6.5
Obiliq	22,815	382	156	2	16.7	6.8	5.2	9.9
Rahovec	41,799	557	271	3	13.3	6.5	5.4	6.8
Pejë	82,745	963	587	3	11.6	7.1	3.1	4.5
Podujevë	70,975	1,075	448	12	15.1	6.3	11.2	8.8
Prishtinë	227,466	2,870	1,152	20	12.6	5.1	7.0	7.6
Prizren	147,246	1,858	944	9	12.6	6.4	4.8	6.2
Skenderaj	40,664	595	316	4	14.6	7.8	6.7	6.9
Shtime	24,308	379	119	3	15.6	4.9	7.9	10.7
Shtërpcë	10,771	110	90	1	10.2	8.4	9.1	1.9
Suharekë	45,749	545	317	6	11.9	6.9	11.0	5.0
Ferizaj	109,255	1,459	581	9	13.4	5.3	6.2	8.0
Viti	35,566	527	229	1	14.8	6.4	1.9	8.4
Vushtri	61,528	917	404	9	14.9	6.6	9.8	8.3
Zubin Potok	763	45	32	0	59.0	41.9	0.0	17.0
Zveçan	434	36	42	0	82.9	96.8	0.0	-13.8
Malishevë	43,888	702	240	3	16.0	5.5	4.3	10.5
Junik	3,943	39	29	0	9.9	7.4	0.0	2.5
Mamushë	5,607	76	23	0	13.6	4.1	0.0	9.5
Hani i Elezit	8,533	100	43	0	11.7	5.0	0.0	6.7
Graçanicë	18,486	151	114	0	8.2	6.2	0.0	2.0
Ranillug	2,481	21	27	0	8.5	10.9	0.0	-2.4
Partesh	3,240	26	35	0	8.0	10.8	0.0	-2.8
Klllokot	3,041	28	16	0	9.2	5.3	0.0	3.9
Mitrovicë Veriore	2,326	103	78	0	44.3	33.5	0.0	10.7
Jashtë Kosove		489	27	0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>Gjithsej</b>	<b>1,585,566</b>	<b>21,487</b>	<b>10,137</b>	<b>126</b>	<b>13.6</b>	<b>6.4</b>	<b>5.9</b>	<b>7.2</b>

Burimi: ASK, Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, 2024  
 Statistikat e Lindjeve dhe statistikat Vdekjeve, 2024